



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 5 regjistër (JR)  
Datë 27.01.2022

Nr. 45 i vendimit  
Datë 17.11.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 17.11.2022, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 5/2022 (JR), datë 27.01.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Jak Ndoka, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 477, datë 24.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Jak Ndoka.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## Grupi gjykses i kolegjit të posaçëm të apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet shtesë, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 477, datë 24.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Jak Ndoka me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.
4. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Jak Ndoka, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ka vlera të dyshimta të transaksioneve të shitblerjes së pasurive, ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklaram të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Jak Ndoka, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë në përfundim të procesit, vendimin nr. 477, datë 24.11.2021.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

6. Me vendimin nr. 477, datë 24.11.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të ankuesit, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës; dhe (b) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia.
7. Komisioni, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Jak Ndoka, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.*

## **III. Shkaqet e ankimit**

Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji) me ankim kundër vendimit nr. 477, datë 24.11.2021, të Komisionit, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

### **A. Pretendime mbi aspektet procedurale të procesit**

8. Subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin e zhvilluar në Komision ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit, si vijon.
  - 8.1. Është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi bazuar në nenin 117, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë viteve. Ndërsa shkeljet dhe pasaktësitë e evidentuara në deklaratat periodike vjetore konstatohen për një periudhë 15-vjeçare dhe për këto shkelje masa disiplinore është dënimi me gjobë dhe jo shkarkimi nga detyra.
  - 8.2. Barra e provës dhe masa disiplinore e dhënë ndaj tij është në shkelje të parimit të proporcionalitetit, pasi neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon se subjekti shkarkohet nga detyra, nëse ka pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme.
  - 8.3. Masa disiplinore e vendosur për pasaktësitë apo shkeljet administrative që mund të jenë kryer në deklaratat vjetore është në kundërshtim me parimin që nuk ka dënim pa ligj (*nullum crimen sine lege*). Në vendimin e Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, janë përdorur koncepte të paqarta dhe të papërcaktuara si *pasaktësi në deklaramin e burimeve financiare, deklaram i pamjaftueshëm të të ardhurave dhe deklaram i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.*
  - 8.4. Subjekti pretendon se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit që kanë shqyrtuar çështjen e tij, nuk plotësojnë kriteret ligjore formale për t’u zgjedhur, sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016. Mënyra si janë zgjedhur anëtarët e Komisionit, statusi dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre nuk garanton procesin e rregullt ligjor, për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj.

**8.5.** Hetimi nga Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit, po nga e njëjta trupë gjyqesore, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i është dhënë koha e mjaftueshme për të paraqitur prova në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të pandemisë, duke iu hequr mundësia për një mbrojtje efektive.

**8.6.** Komisioni, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve i ka mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dëgjuar, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet në lidhje me konstatimet e Komisionit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe gjatë seancës dëgjimore. Trupi gjyqësor, pa marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, e ka ftuar në seancë dëgjimore në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45, 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative.

**8.7.** Dhënia e masës shkarkim nga detyra është bërë në shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, pasi përbën një ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe i ka hequr mundësitë e punësimit sipas kualifikimit dhe eksperiencën e tij profesionale.

## **B. Pretendime për vlerësimin e pasurisë**

9. Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë parashtrohen, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

**9.1.** *Lidhur me pasurinë apartament banimi, me sip. 68 m<sup>2</sup>, lagjja "{\*\*\*}", Lezhë*, subjekti i rivlerësimit në ankim parashton se burimi i krijimit të pasurisë është plotësisht i ligjshëm dhe i dokumentuar dhe vlera reale e shitblerjes në vitin 2007 është 5.300.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes që mban datën 24.04.2007. Blerësi L. M. në momentin e regjistrimit të pasurisë ka paraqitur pranë ZVRPP-së Lezhë një kontratë shitblerjeje të ndryshme nga ajo që kanë paraqitur palët para noterit, me qëllim justifikimin e shumës së kredisë. Vlera reale e shitjes, sipas subjektit, provohet me kontratën e shitblerjes dhe mandatet e depozitimit në bankë të pagesave të kryera nga blerësi në vlerën 5.300.000 lekë. Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm kontratën, sipas ankuesit, e falsifikuar, që blerësi L. M. ka paraqitur në ZVRPP-në Lezhë për regjistrimin e pronës. Komisioni nuk ka thirrur si dëshmitar blerësin dhe nuk ka zhvilluar ekspertim për provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendon se gjetjet e Komisionit janë tërësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me konkluzionet e Komisionit deklarimi i subjektit është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**9.2.** *Lidhur me pasurinë apartament banimi, me sip. 108 m<sup>2</sup> + 20 m<sup>2</sup> njësi, me adresë në lagjen "{\*\*\*}", Lezhë*, subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit parashton se këto dy pasuri janë financuar nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 5.300.000 lekësh. Subjekti pretendon se ka paraqitur në Komision gjithë dokumentacionin ligjor që vërteton krijimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie, nga shitja e së cilës janë përfitur pjesërisht të ardhurat për blerjen e apartamentit me sip. 108 m<sup>2</sup> dhe njësisë së shërbimit me sip. 20 m<sup>2</sup>.

**9.3.** *Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia e njësisë me sip. 20 m<sup>2</sup>, me adresë në lagjen "{\*\*\*}", Lezhë*, subjekti i rivlerësimit parashton se gjatë hetimit administrativ në Komision ka paraqitur argumente se të ardhurat nga qiraja nuk janë përdorur për krijimin e pasurive apartament banimi me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup> dhe njësi shërbimi me sip. 20 m<sup>2</sup> dhe, për pasojë, nuk mund të përdoren nga Komisioni për krijimin e këtyre pasurive, ndërkohë që nuk i ka llogaritur si të ardhura të ligjshme.

9.4. Lidhur me apartamentin me sip. 87,4 m<sup>2</sup>, me adresë Shëngjin, Lezhë, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pambështetur vlerësimin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, pasi Komisioni i referohet për këtë pamundësi vlerës së shitjes së apartamentit me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, duke këmbëngulur se vlera e shitjes së këtij apartamenti është 3.000.000 lekë dhe jo 5.300.000 lekë, sipas kontratës së shitjes dhe dokumentacionit bankar që subjekti ka paraqitur për pagesën e fundit në vlerën 1.500.000 lekë. Lidhur me mospërputhjet në deklaratimet për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendon se ato kanë ardhur nga fakti se gjatë procesit të ndërtimit shoqëria ndërtuese ka kryer disa punime shtesë, të cilat kanë qenë në vlerën 200.000 lekë, dhe se kjo pagesë shtesë nuk është pasqyruar në ndonjë akt për shkak se vlera ka qenë e vogël.

9.5. Lidhur me apartamentin me sip. 103,14 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit kundërshton vlerësimin e Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pjesës 25% të apartamentit, pasi gjatë hetimit administrativ ai ka depozituar faturat bankare të pagesës prej 15.000 eurosh, për shlyerjen e pjesës takuese të apartamentit, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, që mbulojnë tërësisht këtë vlerë të paguar. Gjithashtu, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit parashtron se ka paraqitur gjithë dokumentacionin lidhur me të ardhurat e vëllait në shtetin grek, që provon mundësinë financiare të tij për pagesën e shumës 40.000 euro. Lidhur me konstatimin e Komisionit se nga viti 2012 e në vijim faturat e apartamentit janë në emrin e subjektit, dhe se ky apartament ka qenë në përdorim të subjektit dhe jo të vëllait, subjekti parashtron se përdorimi i apartamentit prej tij ka qenë vetëm për periudhën e shkollës së fëmijëve, me miratimin dhe dijeninë e xhaxhait të tyre. Kontrata e ujit është lidhur në emër të subjektit, pasi i vëllai nuk ka pasur mundësi të vinte në Shqipëri për të lidhur kontratën. Ndërsa pretendimi i Komisionit se vëllai ka blerë një apartament në Shëngjin dhe nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar vlerën 40.000 euro për blerjen e apartamentit në Tiranë, nuk qëndron, pasi të ardhurat e tij janë të dokumentuara me prova shkresore.

9.6. Lidhur me pasurinë automjet “Daimler Chrysler”, blerë me kontratën e datës 21.06.2014, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit, si dhe përlllogaritjen si shpenzime udhëtimet në Greqi dhe në Itali të të afërmit e subjektit, pa marrë në konsideratë dokumentet e paraqitura që vërtetojnë se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga palët e treta. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratat vjetore 2008-2013 të përdorimit të automjetit në pronësi të vëllait, subjekti parashtron se nuk ka pasur nevojë për përdorimin e një mjeti përditë dhe në raste emergjence ka përdorur automjetin e vëllait.

9.7. Lidhur me pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të fituara sipas ligjit nr. 7501, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se burimi i krijimit të tyre është i njohur dhe i ligjshëm dhe fakti që nuk janë deklaruar në vitin 2004, në deklarimin fillestar të pasurisë, ka ardhur si pasojë e pakujdesisë.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Aspekte procedurale**

###### *a) Mbi juridiksionin e Kolegjit*

10. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të

Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Mbi legjitimitimin e ankuesit*

11. Ankuesi Jak Ndoka, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtuar funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit.
12. Vendimi nr. 477, datë 24.11.2021 i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.12.2021, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 21.12.2021. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15-ditor<sup>1</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

*c) Mbi formën e gjykimit të ankimit*

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
14. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të pretendimeve të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet shtesë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

## **B. Mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit**

### **B.1 Analiza e pretendimeve mbi aspektet procedurale të procesit**

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në procesin e zhvilluar në Komision është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi bazuar në nenin 117, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë viteve. Sipas subjektit, shkeljet dhe pasaktësitë e evidentuara në deklaratat periodike vjetore konstatohen për një periudhë 15-vjeçare dhe për këto shkelje masa disiplinore është dënimi me gjobë dhe jo shkarkimi nga detyra, bazuar në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

---

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 03.01.2022 pranë Komisionit ankimin e tij kundër vendimit nr. 477, datë 24.11.2021, protokolluar pranë Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.01.2022.

**15.1.** Kolegji vlerëson se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në ligj. Procesi i rivlerësimit, në kuadër të të cilit ndaj subjektit të rivlerësimit është dhënë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, është i ndryshëm nga procedurat disiplinore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 apo nga kontrolli i pasurive dhe të konfliktit të interesave, sipas ligjit nr. 9049/2003. Rivlerësimi kalimtar, i bazuar në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, kryhet vetëm një herë, përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, për periudhën e ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe në varësi të përfundimit të procesit vendoset konfirmimi në detyrë ose masa disiplinore e pezullimit apo shkarkimit nga detyra. Ky proces kontrolli nuk kufizohet vetëm në një periudhë 5-vjeçare nga kryerja e shkeljes, siç pretendon subjekti, por shtrihet gjatë gjithë periudhës të ushtrimit të funksionit nga subjektet e rivlerësimit.

- 16.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se barra e provës dhe masa disiplinore e dhënë ndaj tij është në shkelje të parimit të proporcionalitetit, pasi neni D i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se subjekti shkarkohet nga detyra, nëse ka pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, ligjvënësi ka përcaktuar si shkak shkarkimi që lidhet me pasurinë vetëm pikën 1, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ndërsa pika 3 e nenit 61, që përbën dhe shkakun e shkarkimit të subjektit, lidhet me konceptin e deklarimit të pamjaftueshëm, por kjo pamjaftueshmëri duhet të lidhet njëkohësisht me deklaratimet e rreme, pra, si rrjedhojë, edhe me kriterin e figurës.

**16.1.** Në shqyrtim të pretendimit se nuk është zbatuar parimi kushtetues i dyfishit të pasurisë së ligjshme, si dhe për aplikimin e barrës së provës të paarsyeshme, Kolegji sjell në vëmendje se deklarimi i më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme është vetëm një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, si shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, ka përdorur pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket pretendimit për barrën e provës, Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar<sup>2</sup> se: *Tashmë është krijuar jurisprudenca në Kolegj në lidhje me faktin e kalimit të barrës së provës subjekteve të rivlerësimit, jo vetëm për dyfishin e pasurisë së ligjshme, por për çdo element kontrolli të pasurisë, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*

**16.2.** Për sa i përket pretendimit se shkak i vetëm shkarkimi për pasurinë është pika 1 e nenit 61, dhe se sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë duhet të lidhet dhe me pamjaftueshmërinë e kriterit të figurës, sillet në vëmendje se tashmë Kolegji ka krijuar një jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sa u takon kriterëve të pasurisë dhe figurës, vlerësimi i tyre është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Shih vendimin nr. 33/2020 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 13.1.

<sup>3</sup> Shih vendimin nr. 35/2022(JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 35.

16.3. Për rrjedhojë, Kolegji arrin në konkluzionin se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

17. Kolegji çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit se konceptet si *pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë*, janë të paqarta dhe të pasqaruara nga ligji nr. 84/2016, nuk mund të shqyrtohen të shkëputura nga shkaqet konkrete të ankimit lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, i cili në vendimin nr. 8/2022 ka arsyetuar se: *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të sigurisë juridike nëpërmjet përdorimit në vendimin e Komisionit të koncepteve të paqarta si “pasaktësi në deklarin e burimeve financiare”, “deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave”, “deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”, trupi gjykues çmon se, referuar edhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me terminologjinë e paqartë të përdorur në ligjin nr. 84/2016, ku citohet: [...] është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë [...], përdorimi nga Komisioni i koncepteve të sipërcituara dhe kuptimi i dhënë atyre në vendim janë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e rivlerësimit të cilit i përkasin. Për rrjedhojë, vetëm fakti i përdorimit të këtyre togfjalëshave në vendimin e Komisionit, pa vlerësuar kontekstin në të cilin kanë gjetur përdorim, si dhe kuptimin që i ka dhënë Komisioni nëpërmjet arsyetimit të tij, nuk vlerësohet i mjaftueshëm për t’u ngritur në nivelin e një shkak ligjor që mund të cenojë vlefshmërinë e vendimit të Komisionit.*
18. Subjekti pretendon se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit që kanë shqyrtuar çështjen e tij, nuk plotësojnë kriteret ligjore formale për t’u zgjedhur, sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016. Mënyra si janë zgjedhur anëtarët e Komisionit, statusi dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre nuk garanton procesin e rregullt ligjor, për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj. Lidhur me sa pretendon subjekti Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e tij për “[...] natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t’i paraprinte emërimin fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar



*më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj.*<sup>4</sup>

19. Për sa i përket pretendimit se hetimi, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit, po nga e njëjta trupë gjyquese, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, trupi gjyques përsërit qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë, është konfirmuar edhe nga shqyrtimi në praktikë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë, në të cilin GjEDNJ-ja ka konstatuar që mënyra se si funksionojnë institucionet e rivlerësimit përmbush standardet e KEDNJ-së, në veçanti ato të nenit 6 §1 të KEDNJ-së<sup>5</sup>. Për këto arsye, trupi gjyques e vlerëson si të pabazuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

20. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk i është dhënë koha e mjaftueshme për të paraqitur prova në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të pandemisë, duke iu hequr mundësia për një mbrojtje efektive, Kolegji konstaton dhe vlerëson si vijon.

20.1. Nga aktet në dosje rezulton se me e-mail-in e datës 08.05.2020 subjekti është njoftuar nga Komisioni për fillimin e hetimit administrativ, si dhe i është dërguar pyetësori standard duke i lënë kohë 15 ditë për dhënien e përgjigjeve dhe të informacionit.

20.2. Në datën 23.05.2020, subjekti me e-mail ka dërguar përgjigjet e pyetjeve që përmbante pyetësori, si dhe provat bashkëlidhur. Në këtë e-mail subjekti nuk ka bërë ndonjë kërkesë për zgjatje afati.

20.3. Në datën 28.12.2020, subjektit i është dërguar nga Komisioni pyetësori nr. {\*\*\*}, duke i lënë një afat 15 ditor për t'u përgjigjur. Me e-mail-in e datës 07.01.2021, subjekti ka kërkuar më shumë kohë për dërgimin e informacionit të plotë dhe Komisioni e ka shtyrë afatin deri në datën 20.01.2021 (me 8 ditë). Me e-mail-in e datës 20.01.2021, subjekti ka dërguar përgjigjet e pyetësorit nr. {\*\*\*}, si dhe dokumentacionin shoqërues.

20.4. Në datën 16.09.2021, Komisioni i ka dërguar subjektit pyetësorin nr. {\*\*\*}, duke i lënë afat për kthimin e përgjigjeve deri në datën 27.09.2021. Subjekti i rivlerësimi ka dërguar përgjigjet, si dhe dokumentacionin përkatës me dy e-mail-e të datës 27.09.2021.

20.5. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit në datën 15.11.2021 ka dërguar në Komision prapësimet së bashku me provat përkatëse.

20.6. Nga gjithë komunikimi i mësipërm rezulton se subjekti u është përgjigjur pyetësorëve brenda afateve të përcaktuara nga Komisioni, si dhe i është dhënë mundësia e shtyrjes së afatit kur ka pasur nevojë për më tepër kohë. Kolegji vëren se është e vërtetë që periudha në të cilën i është kërkuar informacioni subjektit ka qenë gjatë kohës së pandemisë (maj-shtator 2020), por pavarësisht kufizimeve, institucionet publike kanë qenë funksionale dhe nuk ka pasur pengesa reale për kryerjen e veprimeve, siç rezulton dhe nga kthimi brenda afateve të përgjigjeve nga subjekti. Prandaj, Kolegji vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në fakte.

<sup>4</sup> Shih vendimin nr. 43/2022(JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 14.2.iv.

<sup>5</sup> Shih Vendimin Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 307, 308 dhe 317.

21. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet në lidhje me konstatimet e Komisionit. Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, Kolegji, nga verifikimi i veprimtarisë procedurale të zhvilluar në Komision, konstaton se subjektit i është dhënë mundësia për të paraqitur argumentet dhe provat për çdo çështje të ngritur në rezultatet e hetimit. Nga e-mail-et e cituara më sipër rezultojnë se subjekti ka dhënë shpjegimet, si dhe ka paraqitur prova për gjithçka që ka vlerësuar të nevojshme referuar gjetjeve për të cilat Komisioni i ka kaluar barrën e provës. Gjithashtu, gjatë seancave dëgjimore të datave 19.11.2021 dhe 22.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision argumentet e tij lidhur me rezultatet e hetimit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar e mbrojtur rezultojnë të jetë i pabazuar.
22. Për sa i përket pretendimit se trupi gjykues i Komisionit ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore pa marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45, 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2, shkronja "ç" e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit "Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", rezultojnë se:

22.1. Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave, sipas kërkesave të nenit 48<sup>6</sup> të Kodit të Procedurave Administrative, dhe se seancat dëgjimore kanë qenë tërësisht formale, Kolegji çmon se Komisioni, vlerësimin për çdo provë, dokument dhe shpjegim, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, e kryen në tërësi nëpërmjet vendimit përfundimtar. Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit konstatohet se shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, si dhe aktet mbi të cilat është bazuar, janë pasqyruar në rubrikën e veçantë "Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit". Gjithashtu, rezultojnë se Komisioni në vendim, për çdo pasuri të marrë në shqyrtim, ka analizuar duke iu referuar dokumentacionit të disponuar, si dhe shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës. Kolegji e gjen të pabazuar dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se seancat dëgjimore kanë qenë formale, pasi nga aktet në fashikuj rezultojnë se gjatë këtyre seancave subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën dhe i është dhënë mundësia të kundërshtojë çdo gjetje të Komisionit të relatuar nga ana e relatorit të çështjes, të shpjegojë të gjitha faktet dhe provat e mbledhura në kuadër të kalimit të barrës së provës, si dhe të parashtojë çdo kërkesë që ai ka vlerësuar në interes të mbrojtjes së tij.

22.2. Ndërkohë, Kolegji vlerëson si të pabazuar në fakte dhe pretendimin se procedura e ndjekur nga Komisioni bie ndesh me parashikimin e nenit 87<sup>7</sup>, pika 2 e Kodit të Procedurave

---

<sup>6</sup> Neni 48: "Organi publik, në çdo rast është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi".

<sup>7</sup> Neni 87, "Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar", i Kodit të Procedurave Administrative përcakton shprehimisht: "1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: (a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; (b) palët e përfshira; (c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; (ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; (d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte; (dh) datën e fillimit të

Administrative. Nga aktet në fashikuj rezulton se subjekti i rivlerësimit, me njoftimin e datës 08.05.2020 ka marrë dijeni për trupin gjykues, si dhe për relatorin që do të shqyrtonte çështjen e tij. Komisioni, me komunikimin e bërë nëpërmjet e-mail-it të datës 4.11.2021, në vijim të vendimit nr. {\*\*\*} të së njëjtës datë të trupit gjykues për përfundimin e hetimit paraprak, ka përmbushur, pikërisht, kërkesat e kësaj dispozite ligjore, duke i njoftuar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit, të drejtën për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera, si dhe duke i lënë afat deri në datën 15.11.2021 për të sjellë prova apo shpjegime të tjera. Në datën 17.11.2021, subjekti është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 19.11.2021, për të cilën më pas ka kërkuar ndryshimin e orarit, kërkesë që i është pranuar nga Komisioni.

23. Subjekti pretendon se dhënia e masës shkarkim nga detyra është bërë në shkelje të parimit të proporcionalitetit, pasi përbën një ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të parashikuara nga neni 8 i KEDNj-së. Subjekti parashtron në ankim se si pasojë e masës së vendosur ndaj tij ka humbur të gjitha shanset për të pasur një mundësi punësimi që përkon me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale. Subjekti pretendon se nuk mund të ushtrojë për të gjithë jetën profesionin e gjyqtarit, dhe se për shkak të masës disiplinore nuk mund të aplikojë për një detyrë a funksion në administratën publike, nuk mund të jetë noter, avokat apo ekspert i pavarur.

23.1. Kolegji konstaton se pretendimi për cenim të nenit 8 të KEDNj-së është trajtuar edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë ka arsyetuar se: *362. GjEDNj-ja vëren se, gjatë vlerësimit të zbatimit të nenit 8 në çështjen në fjalë, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet sipas qasjes së bazuar në arsye: shkarkimi i kërkueses nga detyra gjyqësore në lidhje me detyrën e saj si gjyqtare nuk kishte asnjë lidhje me jetën e saj private. Ndërkohë që përfitimi ose krijimi i pasurive mund të konsiderohet të jetë një aspekt i jetës private, nuk është numri ose madhësia e asetëve ose stili i jetës së një individi ai që mund të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, por paaftësia e individit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për përfitimin ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij ose të saj [...]. Gjykata është e bindur që ndërhyrja në jetën private të kërkueses ishte në përputhje me ligjin, siç kërkohet nga neni 8, paragrafi 2 i Konventës. [...] 393. Në këto rrethana, GjENDJ-ja nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji nr. 84/2016 në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen e kërkueses në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 2.*

23.2. Kolegji e gjen të pabazuar dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se me shkarkimin nga funksioni i gjyqtarit ka humbur mundësitë për punësim. Kolegji vëren se si pasojë e shkarkimit nga detyra, në kuadër të procesit të rivlerësimit, magjistrati humbet të drejtën për të punuar në sistemin e drejtësisë, por nuk humbet të drejtën dhe nuk kufizohet për të punuar në sektorë të tjerë publikë apo privatë.

24. Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji i gjen të pabazuara në fakte dhe në ligj shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, për shkelje procedurale dhe cenim të së drejtës së tij për

---

*procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm”.*

proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 8 të KEDNJ-së.

## **B. 2 Analiza e pretendimeve mbi vlerësimin e pasurisë**

*i) Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Lezhë*

25. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, pas analizës së kryer mbi krijimin e kësaj pasurie, ka arsyetuar në vendim se: 1.31. *Trupi gjykues, në analizë të provave, mbështetur në dokumentacionin ligjor të ZVRPP-së Lezhë dhe në dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, vlerësoi se shuma e përfituar nga subjekti i rivlerësimit, nga shitja e apartamentit me sip. 68 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë, është 3.000.000 lekë, pasi për këtë shumë janë paguar edhe detyrimet tatimore bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. 1.32. Për sa kohë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime të pasakta dhe të pambshtetura në dokumentacionin ligjor provues, të cilat lidhen me të ardhurat e ligjshme të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, e vendosin në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe në gerrat “a” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. 1.33. Në përfundim, Komisioni konstaton se lidhja dhe nënshkrimi i disa kontratave për të njëjtën pasuri, me ndikim edhe në burimet financiare për pasuritë e krijuara më pas, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, si dhe në një vlerësim tërësor bazuar në pikën 2, të nenit 4, të çojnë në zbatimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, dhe se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

26. Lidhur me vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

26.1. Burimi i krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Lezhë, është plotësisht i ligjshëm dhe i dokumentuar dhe vlera reale e shitblerjes në vitin 2007 është 5.300.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes që mban datën 24.04.2007. Blerësi L. M., në momentin e regjistrimit të pasurisë, ka paraqitur pranë ZVRPP-së Lezhë një kontratë shitblerjeje të ndryshme nga ajo që kanë paraqitur palët para noterit, me qëllim justifikimin e shumës së kredisë. Vlera reale e shitjes, sipas subjektit, provohet me kontratën e shitblerjes dhe mandatet e depozitimit në bankë të pagesave të kryera nga blerësi në vlerën 5.300.000 lekë. Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm kontratën, sipas ankuesit, e falsifikuar, që blerësi L. M. ka paraqitur në ZVRPP-në Lezhë për regjistrimin e pronës. Komisioni nuk ka thirrur si dëshmitar blerësin dhe nuk ka zhvilluar ekspertim për provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 84/2016.

26.2. Gjetjet e Komisionit për këtë pasuri janë tërësisht të pabazuara pasi deklarimi i subjektit është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

27. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara më sipër, Kolegji, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se:

27.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2001, për shumën 557.985 lekë, të paguar me tri këste prej kursimeve *cash* të krijuara nga paga.

27.2. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi në bashkëpronësi të palëve ndodhet në katin e dytë, shkalla nr. {\*\*\*}, banesa nr. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*} tip {\*\*\*}, lagjja “{\*\*\*}”, qyteti Lezhë. Pjesa takuese: 50%. Kontrata shitblerjes, datë 18.10.2001, me Entin Kombëtar të Banesave, Dega Lezhë. Pallatet e reja lagjja ‘{\*\*\*}’, qyteti Lezhë.*

27.3. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar pakësim pasurie, shitur apartament 2+1, me sip. 68 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë, në shumën 5.300.000 lekë.

27.4. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.1.2020, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore e ASHK-së Lezhë, ka bashkëlidhur kartelën e pasurisë për apartamentin me sip. 68 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasit L. M., blerë me kontratë shitje, datë 27.4.2007, nga shtetasit Jak dhe D. Ndoka, në shumën 3.000.000 lekë.

27.5. Për shitjen e kësaj pasurie rezulton të jenë lidhur disa kontrata nga ana e subjektit të rivlerësimit, konkretisht: (i) aktmarrëveshje nr. {\*\*\*}, datë 19.4.2007, pranë noter V. Gj. M., sipas së cilës çmimi i shitjes është 5.300.000 lekë, ku është likuiduar shuma 2.300.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër në shumën 3.000.000 lekë do të likuidohet brenda një afati të arsyeshëm, prej 3-4 muajsh, kur pala blerëse të sigurojë kredinë; (ii) aktmarrëveshje nr. {\*\*\*}, datë 24.04.2007, pranë noter V. Gj. M., ku çmimi rezulton 5.300.000 lekë, ndërsa pagesa do të bëhet me dy këste: kësti i parë prej 3.000.000 lekësh do të paguhet me marrjen e kredisë, ndërsa shuma prej 2.300.000 lekësh do të likuidohet deri më 31.12.2007; (iii) kontratë e shitblerjes së pasurisë nr. {\*\*\*}, datë 24.4.2007, pranë noter V. Gj. M., çmimi i shitjes është 5.300.000 lekë, i cili është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale; (iv) kontratë e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*}, datë 24.04.2007, pranë noter V. Gj. M., çmimi i shitjes së apartamentit është 3.000.000 lekë<sup>8</sup>. Bashkëlidhur dhe mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 27.04.2007, me vlerë 30.000 lekë, (3.000.000 lekë \* 1%, tatim për kalimin e pronësisë), me përshkrim: *arkëtuar nga Jak Ndoka*<sup>9</sup>; (v) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2008, pranë noter V. Gj. M., ku palët deklarojnë se kanë nënshkruar kontratë shitblerje të pasurisë dhe në datën 12.05.2008 blerësi ka likuiduar këstin e fundit prej 1.500.000 lekësh.

28. Kolegji, pas verifikimit të akteve, vlerëson se pavarësisht pretendimit për përfitimin e shumës prej 5.300.000 lekësh nga shitja e apartamentit, subjekti nuk arrin të provojë kalimin e kësaj shume për llogari të tij, me transaksione bankare apo *cash*. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka paraqitur disa mandate depozitimi në bankë të pagesave të kryera nga blerësi në vlerën 5.300.000 lekë, ndërkohë që nga aktet në fashikull, sipas të dhënave të “Raiffeisen Bank”, dërguar Komisionit, nga lëvizjet bankare vërtetohet vetëm pagesa e vlerës prej 3.000.000 lekësh, në datën 02.05.2007, me përshkrim “{\*\*\*} L. M. *lik. pagesë blerje shtëpie*”, por jo e vlerës së pretenduar prej 5.300.000 lekësh.

28.1. Lidhur me pretendimin e subjektit, se një pjesë të të ardhurave nga shitja e apartamentit i ka përfituar pas lidhjes së kontratës së shitblerjes, rezulton se subjekti ka deklaruar në DPV-në 2008 se vlera 1.500.000 lekë ka shërbyer si pagesë për blerjen e apartamentit me sip. 87,4 m<sup>2</sup> (*trajtuar me poshtë*), duke iu referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2008, pranë noter V. Gj. M., ku palët deklarojnë se kanë nënshkruar kontratë shitblerjeje të pasurisë dhe në datën 12.05.2008 blerësi ka likuiduar këstin e fundit prej 1.500.000 lekësh. Por, nga aktet rezulton se subjekti nuk arrin të provojë kalimin e kësaj shume në llogari të tij, as me transaksion bankar, as me gjendje *cash* dhe, për

<sup>8</sup> Këtë kontratë ka paraqitur subjekti i rivlerësimit në Komision, bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore.

<sup>9</sup> Aktet janë sjellë bashkëlidhur përgjigjes së ZQRPP, me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

rrjedhje, përfitimi i kësaj shume mbetet vetëm në nivel deklarativ. Gjithashtu, subjekti në deklaratat periodike vjetore nuk jep asnjë të dhënë për pjesën e mbetur nga pagesa e këstit të dytë të pretenduar nga shitja e apartamentit në vlerën 2.300.000 lekë, pas përdorimit të shumës 1.500.000 lekë që ka shërbyer si pagesë për blerjen e apartamentit në vitin 2008.

29. Kolegji e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, i cili ka konsideruar si të ardhura të ligjshme nga shitja e apartamentit vlerën prej 3.000.000 lekësh, jo vetëm për shkak se subjekti nuk arrin të provojë përfundimin e vlerës prej 5.300.000 lekësh nga shitja e apartamentit, por edhe se nuk provon as pagesën e detyrimit tatimor për këtë të ardhur. Nga aktet rezulton se në ZVRPP-në Lezhë, bazë për kalimin e pronësisë është marrë kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*}, datë 24.4.2007, me çmim shitjeje të apartamentit vlerën 3.000.000 lekë. Në bazë të kësaj kontrate është bërë dhe pagesa e tatimit për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme.
30. Për sa më sipër, Kolegji, në përmbushje të kërkesave të nenit D, pika 3, të Kushtetutës, gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për konsiderimin si të ardhur të ligjshme nga shitja e apartamentit, të vlerës 3.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 24.4.2007.
31. Për sa i përket pretendimit për depozitimin e një kontrate të falsifikuar në ZVRPP nga blerësi, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhej t'u ishte drejtuar organeve kompetente, që në momentin e konstatimit të këtij fakti në fazën e hetimit administrativ në Komision, kur ka marrë dijeni për ekzistencën e një kontrate, sipas tij, me çmim të ndryshëm, ashtu si dhe është shprehur vetë subjekti në shpjegimet e dhëna në Komision ku ka deklaruar se *falsifikatori do të shkojë para drejtësisë*. Ekzistenca e disa akteve (dy kontrata dhe dy aktmarrëveshje), të së njëjtës datë, me të dhëna të ndryshme, për të njëjtën pasuri, të firmosura nga vetë subjekti i rivlerësimit, nuk e justifikon pretendimin e tij se vetëm blerësi ka vepruar në keqbesim, duke depozituar një kontratë që nuk pasqyrore vlerën reale të shitblerjes. Subjekti nuk ka arritur të shpjegojë interesin dhe përfitimin e palës blerëse në këtë rast, pasi i vetmi përfitues nga ky veprim, ka qenë vetë ai, si mbartës i detyrimit për pagesën e tatimit për kalimin e pronësisë. Kolegji vëren se në këtë rast nuk mund të flitet për pasaktësi në deklaram, siç pretendon subjekti, por për veprime që kanë pasur si synim të shmangin pagesën e detyrimeve tatimore.
32. Komisioni ka konstatuar se lidhja dhe nënshkrimi i disa kontratave për të njëjtën pasuri, me ndikim edhe në burimet financiare për pasuritë e krijuara më pas, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, si dhe në një vlerësim tërësor bazuar në pikën 2 të nenit 4, të çojnë në zbatimin e pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, Kolegji çmon se këto veprime të subjektit të rivlerësimit nuk përfaqësojnë një situatë faktike që cenon besimin e publikut të subjekti i rivlerësimit si pjesë e sistemit të drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për më tepër që paraqitja e disa kontratave dhe ndikimi që ka pasur ky veprim në ligjshmërinë e burimeve financiare për krijimin e pasurisë janë konsideruar nga Komisioni, konfirmuar edhe nga Kolegji, si deklaram i rremë nga ana e subjektit, në lidhje me nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.
33. Në përfundim, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Lezhë, Kolegji konsideroi si të ardhur të ligjshme nga shitja e apartamentit vlerën 3.000.000 lekë dhe arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime të pasakta dhe ka bërë deklaram të rremë lidhur me çmimin e këtij apartamenti, të cilat e vendosin subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “ç” dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

ii) *Lidhur me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup> + 20 m<sup>2</sup> njësi me adresë, lagjja “{\*\*\*}”, Lezhë*

34. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar apartamentin me sip. 108 m<sup>2</sup> + njësi shërbimi me sip. 20 m<sup>2</sup>, blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.11.2007, me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, përkatësisht në shumat 3.200.000 lekë apartamenti dhe 600.000 lekë njësia e shërbimit. Si burim për blerjen e apartamentit dhe njësisë subjekti ka deklaruar pagesën e kështit të parë nga shitja e apartamentit me sip. 68 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë.
35. Në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *Porositje ambient shërbimi me sip. 20 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Lezhë, me vlerë 860.000 lekë, me burim tërheqjet nga “Raiffeisen Bank”.*
36. Në DPV- në e vitit 2007, në ndryshimet e interesave private, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: *(i) shtuar pasuria apartament banimi me sip. 108 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë, në vlerën 3.200.000 lekë; (ii) shtuar pasuria, njësi tregtimi me sip. 20 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë, në vlerën 600.000 lekë [...], por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament dhe njësi shërbimi.*
37. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaratimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive, ka arsyetuar në vendimin e tij se: *Ka mospërputhje midis deklaratës vetting dhe deklaratave vjetore të interesave private. Në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i pranoi këto mospërputhje duke i justifikuar me faktin e mosruajtjes së deklaratave vjetore të interesave private. Subjekti në deklaratën e interesave periodike të vitit 2006 ka deklaruar shtim të pasurisë, porositje të njësisë së shërbimit me sip. 20 m<sup>2</sup>, në vlerën 860.000 lekë, me burim tërheqjet nga “Raiffeisen Bank”. Në deklaratën e interesave private në vitin 2007, deklaroi blerje apartamenti me sip. 108 m<sup>2</sup>, me çmim 3.200.000 lekë dhe njësi shërbimi me sip. 20 m<sup>2</sup>, me çmim 600.000 lekë, pa deklaruar burimin. Sa i takon mundësisë financiare të subjektit për blerjen e këtyre pasurive në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë, në shumën 3.800.000 lekë, në vitin 2007, me burime të ligjshme, bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2007, u konstatua pamjaftueshmëri për blerjen e apartamentit me sip. 108 m<sup>2</sup> dhe njësisë me sip. 20 m<sup>2</sup>, duke e vendosur subjektin në situatën faktike të parashikuar nga germat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në analizë të provave, konstatoi se subjekti është jo koherent në raport me faktet dhe është përpjekur të fshehtë të vërtetën, për sa u takon të dhënave që lidhen me justifikimin e burimeve të të ardhurave.*
38. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit pasi, sipas tij, këto dy pasuri janë financuar nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 5.300.000 lekësh. Subjekti pretendon se ka paraqitur në Komision gjithë dokumentacionin ligjor që vërteton krijimin me burime të ligjshme të apartamentit, nga shitja e të cilit janë përfutur pjesërisht të ardhurat për blerjen e apartamentit 108 m<sup>2</sup> dhe njësisë së shërbimit 20 m<sup>2</sup> me adresë në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë.
39. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të akteve të depozituara në Komision, Kolegji konstaton dhe vlerëson se:
- 39.1. Subjekti pretendon se burim i krijimit të dy pasurive, apartament dhe njësi shërbimi, janë të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 68 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë. Nga analiza më sipër për të ardhurat e shitjes së këtij apartamenti, në paragrafin 32 të këtij vendimi,

Kolegji ka konsideruar si të ardhura të ligjshme të përfituara nga shitja e apartamentit vlerën 3.000.000 lekë. Për këtë arsye, Kolegji konkludon se subjekti arrin të justifikojë të ardhurat për blerjen e apartamentit dhe njësisë së shërbimit deri në vlerën e të ardhurave të ligjshme të përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm, bazuar në deklaratimet e tij se janë përdorur vetëm këto të ardhura.

39.2. Sa i takon çështjes së mospërputhjeve midis deklaratës *vetting* dhe deklaratave vjetore të interesave private për njësinë e shërbimit me sip. 20 m<sup>2</sup>, Kolegji konstaton nga aktet se në DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar vlerën 860.000 lekë, ndërsa në deklaratën *vetting*, referuar kontratës së shitblerjes me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, datë 30.11.2007, njësia e shërbimit është deklaruar e blerë në vlerën 600.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo mospërputhje ka ardhur nga mosruajtja prej tij e kopjeve të deklaratave vjetore, por pa specifikuar se cila është vlera reale e blerjes së njësisë. Kolegji, duke i konsideruar si të pabazuara në prova shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se si vlerë e blerjes së njësisë, sipas deklaratimit të bërë nga subjekti në deklaratën *vetting*, si dhe kontratës mbi bazën e të cilës është bërë kalimi i pronësisë, duhet të konsiderohet vlera 600.000 lekë.

40. Për sa më sipër, duke konsideruar si burim të ligjshëm të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm me sip. 68 m<sup>2</sup>, në vlerën 3.000.000 lekë, Kolegji, lidhur me apartamentin me sip. 108 m<sup>2</sup> dhe njësinë me sip. 20 m<sup>2</sup>, konfirmon analizën financiare të Komisionit, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar këto pasuri dhe shpenzimet e kryera në shumën prej (-) 859.867 lekësh, për vitin 2007.
41. Në përfundim, trupi gjykues e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

*iii) Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia e njësisë me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Lezhë*

42. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja e njësisë në shumën 60.000 lekë, duke iu referuar kontratës nr. {\*\*\*}, datë 30.09.2015. Në DPV-të për vitet 2008, 2009 dhe 2010, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e njësisë së shërbimit me sip. 20 m<sup>2</sup>, në vlerën 200.000 lekë në vit.
43. Komisioni konstatoi mospërputhje midis deklaratimit të të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit në deklaratën *vetting* dhe deklaratave të interesave private periodike vjetore. Në deklaratën e interesave private për vitet 2008, 2009 dhe 2010, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja shumën 200.000 lekë në vit, ndërsa në deklaratën *vetting* ka deklaruar shumën 60.000 lekë. Pretendimet e subjektit se tatimi mbi të ardhurat nga qiraja është paguar nga qiramarrësit nuk u provua me dokumentacion ligjor provues. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se pasuria e llojit njësi shërbimi nuk rezultoi e regjistruar në sistemin informatikë të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Lezhë, për qëllime biznesi nga të tretet, ndërsa DRT-ja Lezhë nuk konfirmon tatim mbi të ardhura personale (qiraje) për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur. Komisioni vendosi të mos i konsiderojë të ligjshme, për qëllime të ligjit nr. 84/2016, të ardhurat nga qiraja, pasi nuk u vërtetua pagesa e detyrimeve tatimore, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.



44. Subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, parashton se gjatë hetimit administrativ në Komision ka paraqitur argumente se të ardhurat nga qiraja nuk janë përdorur për krijimin e pasurive apartament banimi me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup> dhe njësi shërbimi 20 m<sup>2</sup> dhe, për pasojë, nuk mund të konsiderohen si burim për krijimin e këtyre pasurive, ndërkohë që Komisioni nuk i ka llogaritur edhe si të ardhura të ligjshme.
45. Lidhur me sa pretendon subjekti, Kolegji konstaton se në vendimin nr. 477, datë 24.11.2021, Komisioni nuk i ka konsideruar të ardhurat nga qiraja si burim për krijimin e dy pasurive apartament dhe njësi shërbimi. Në vendim Komisioni është shprehur vetëm për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, bazuar në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën *vetting* të subjektit të rivlerësimit, si dhe në aktet e marra gjatë hetimit administrativ.
46. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për sa u përket të ardhurave nga qiraja, pas verifikimit të akteve të sjella nga Komisioni, Kolegji vëren se:
- 46.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e njësisë, sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 30.09.2015. Kjo kontratë është lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe personit fizik “{\*\*\*}” (subjekt tregtar). Sipas kësaj kontrate qiramarrësi ka marrë përsipër të paguajë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë, si dhe nga përdorimi i këtij objekti, përfshirë këtu tatimet dhe taksat përkatëse.
- 46.2. Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008, 2009 dhe 2010, subjekti deklaron të ardhura nga qiraja, për çdo vit, në vlerën 200.000 lekë në vit, pa iu referuar ndonjë kontrate qiradhënieje. Në përgjigje të barrës së provës në Komision, subjekti ka paraqitur kontratën e qirasë nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2010, lidhur midis shtetasit M. N. në cilësinë e qiradhënësit dhe shtetases R. P. në cilësinë e qiramarrëses, sipas së cilës qiraja mujore ishte 20.000 lekë dhe qiramarrësi kishte detyrimin e pagesës së ngarkesës fiskale.
- 46.3. Për periudhën 2010-2015, njësia i është dhënë në përdorim vëllait të subjektit të rivlerësimit, M. N., sipas kontratës së uzufuktit nr. {\*\*\*}, datë 08.07.2010, e cila nga hetimi në Komision ka rezultuar se nuk është regjistruar në ZVRPP-në Lezhë, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 235, paragrafi 2 i Kodit Civil, se *uzufukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme*. Sipas kësaj kontrate, tatimet, taksat dhe detyrimet e tjera në ngarkim të pronës gjatë uzufuktit janë në ngarkim të pronarit, subjektit të rivlerësimit.
- 46.4. Në lidhje me kontratën e uzufuktit, subjekti, në datën 13.10.2014, sipas procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja<sup>10</sup> pyetjes se kush i ka përfituar të ardhurat nga uzufukti, i është përgjigjur, ndër të tjera, se: *[...] vëllai im ka pasur një kredi në BKT dhe për garantimin e kredisë i kam dhënë një kontratë uzufukti një njësi dyqan dhe faktikisht të ardhurat i kam marrë personalisht. Nuk kam paguar detyrime fiskale ndaj shtetit as për vitin 2009 as për vitin 2010 [...]*.
- 46.5. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 4.10.2021 ka informuar Komisionin se pasuria (njësi shërbimi) me nr. {\*\*\*}, ZK nr. {\*\*\*}, Vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, nuk figuron që të jetë përdorur për qëllime biznesi nga të tretët.
- 46.6. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.10.2021, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, në përgjigje të kërkesës për informacion nga Komisioni lidhur me të ardhurat nga qiradhënia, ka informuar se nuk

<sup>10</sup> Dërguar Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.01.2020.

gjendet informacion në lidhje me të ardhura personale të deklaruara nga shtetasit Jak Ndoka dhe D. N., për periudhën 2007-2016.

46.7. Në shpjegimet e dhëna në Komision, subjekti është shprehur se: *Nuk kam paguar asnjë taksë në lidhje me të ardhurat e deklaruara të qirasë që kam përfituar nga kjo pronë, këto kontrata janë depozituar përpara organeve kompetente nga qiramarrësit kur janë pajisur me lejet përkatëse të ushtrimit të aktivitetit, si floktore apo zyrë dhe nuk më është komunikuar deri më sot asnjë detyrim në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

47. Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht deklarimit të të ardhurave nga qiraja, për periudha të ndryshme kohore, në deklaratat vjetore dhe në deklaratën *vetting*, nuk arrin të provojë pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale nga qiraja, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat". Subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë detyrim, sipas kontratave të qiramarrjes, e kanë pasur qiramarrësit, por nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor këtë pretendim. Nga informacioni i dhënë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Lezhë dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, rezulton se për njësinë e shërbimit nuk konfirmohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, si nga subjekti i rivlerësimit, ashtu dhe nga qiramarrësi, person fizik tregtar, që ka pasur detyrimin e mbajtjes në burim të tatimit, sipas nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat". Për sa më sipër, për shkak se subjekti nuk ka arritur të provojë pagesën e detyrimeve tatimore, Kolegji çmon se është i drejtë konkluzioni i Komisionit që nuk i ka konsideruar të ligjshme këto të ardhura, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

*iv) Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 87,4 m<sup>2</sup>, me adresë Shëngjin, Lezhë*

48. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, ka vlerësuar se ka mospërputhje në lidhje me kohën e blerjes së kësaj pasurie, çmimin e blerjes, sipërfaqen, si dhe burimin e krijimit. Lidhur me të ardhurat për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni ka konkluduar se: *Në lidhje me burimin e pretenduar të të ardhurave, konkretisht, shumën prej 1.500.000 lekësh që subjekti deklaroi si të ardhur nga pagesa e këstit të dytë të apartamentit të shitur në lagjen "{\*\*\*}", Lezhë dhe e përdorur si burim për apartamentin më sip. 87,4 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, Komisioni vlerësoi të mos e llogarisë si të ardhur, pasi vlera e shitjes së apartamentit në lagjen "{\*\*\*}" u provua me dokumentacion se është 3.000.000 lekë, shumë e cila është shlyer totalisht nga blerësi. Të ardhurat që subjekti pretendon se i ka marrë nga blerësi i apartamentit në lagjen "{\*\*\*}", në vitin 2008 mbetet vetëm në kuadrin deklarativ të pambështetur në prova. Ndërsa për sa i përket burimit të kursimeve nga të ardhurat, në DPV-të e viteve 2009 dhe 2010, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve cash. Trupi gjykues, për sa i përket të ardhurave të pretenduara të përdorura për këtë pasuri, vlerëson se një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë, materializuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave prej 1.500.000 lekësh dhe nuk ka arritur të provojë në këtë mënyrë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të përfshihen si burim krijimi për këtë pasuri, si dhe nuk ka provuar përdorimin e kursimeve cash si burim për pagesën, duke passjellë konkluzionin se duket se subjekti nuk ka arritur të provojë burimet e ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti.*

49. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 87,4 m<sup>2</sup>, pasi Komisioni ka konsideruar si vlerës së shitjes të apartamentit me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup> shumën 3.000.000 lekë dhe jo shumën 5.300.000 lekë, sipas kontratës së shitjes dhe dokumentacionit bankar që subjekti ka paraqitur për pagesën e fundit, në vlerën 1.500.000 lekë. Ndërsa, lidhur me mospërputhjet në deklaratimet për këtë pasuri, subjekti sqaron se ato kanë ardhur nga fakti se gjatë procesit të ndërtimit shoqëria ndërtuese ka kryer disa punime shtesë të cilat kanë qenë në vlerën 200.000 lekë dhe kjo pagesë shtesë nuk është pasqyruar në ndonjë akt për shkak se vlera ka qenë e vogël.

50. Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri referuar dokumentacionin të fashikullit, Kolegji konstaton dhe vlerëson se:

50.1. Sipas deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 87,452 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me kontratën e datës 22.4.2010, për shumën 2.600.000 lekë, me burim të ardhurat e përfituara nga kësti i dytë i çmimit të shitjes së pasurisë apartament me sip. 68 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Lezhë dhe kursime nga të ardhurat.

50.2. Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar shtim apartament banimi 1+1, me sip. 73 m<sup>2</sup> në qytetin e Shëngjinit, në shumën 2.400.000 lekë, nga kjo vlerë janë paguar 1.500.000 lekë (kjo shumë ka ardhur nga pagesa që ka realizuar blerësi i banesës në lagjen “{\*\*\*}”; mbetet për t’u paguar edhe shuma 900.000 lekë).

50.3. Në DPV-në e vitit 2009, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar shlyerje të shumës prej 500.000 lekësh nga detyrimi i shoqërisë ndërtuese të apartamentit të banimit me sip. 87,4 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, vlera e mbetur e detyrimit të papaguar në shumën 400.000 lekë. Nuk ka deklaruar burimin e kësaj pagese.

50.4. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk deklaron detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë.

50.5. Sipas deklarimeve të subjektit, në deklaratën periodike të vitit 2008, kësti i dytë i çmimit të shitjes së apartamentit me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.500.000 lekë, ka shërbyer si pagesë për blerjen e apartamentit me sip. 87,4 m<sup>2</sup>, duke iu referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2008, pranë noter V. Gj. M., ku palët deklarojnë se kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes së pasurisë dhe në datën 12.05.2008 blerësi ka likuiduar këstin e fundit prej 1.500.000 lekësh. Ashtu si dhe është analizuar më sipër në paragrafin 28.1 të këtij vendimi, Kolegji ka konkluduar se subjekti nuk ka arritur të provojë kalimin e shumës 1.500.000 lekë në llogari të tij, as me transaksion bankar dhe as me gjendje *cash*, si dhe pagesën e detyrimit tatimor për përfitimin e saj, si një shumë që pretendohet si e ardhur nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”. Kolegji çmon se përfitimi i kësaj shume ka ngelur vetëm në nivel deklarativ dhe, për pasojë, nuk mund të konsiderohet si një e ardhur e ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 87,4 m<sup>2</sup>.

50.6. Kolegji vëren se subjekti në DPV-në e vitit 2009 ka deklaruar dhe një pagesë tjetër për shlyerjen e çmimit të apartamentit, në vlerën 500.000 lekë, pa deklaruar burimin e kësaj shume, si dhe nuk ka dhënë informacion nëse është shlyer kësti i fundit i pagesës së apartamentit në vlerën 400.000 lekë. Duke marrë për bazë deklarin e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* se si burim për blerjen e apartamentit kanë shërbyer kursimet dhe të ardhurat në *cash* të deklaruara më parë, si dhe bazuar në deklarin e subjektit në deklaratat vjetore 2008 dhe 2009, konstatohet se subjekti e ka paraqitur ndryshimin/shtesën e *cash*-it dhe nuk mund të penalizohet për mosdeklarim të *cash*-it, por për

mosdeklarim të burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të apartamentit. Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për të krijuar kursime *cash* dhe të ardhura të tjera për blerjen e pasurisë dhe kryerjen e shpenzimeve, Kolegji konstaton se në vendim Komisioni në përfundim ka konkluduar për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, duke mos përcaktuar mungesën apo vlerën negative dhe duke e lidhur pamjaftueshmërinë me diferencat negative të analizës së viteve 2008, 2009 dhe 2010, respektivisht: në vitin 2008 në vlerën (-) 1.291.922 lekë; në vitin 2009 në vlerën (-) 262.944 lekë; dhe në vitin 2010 në vlerën (-) 984.321 lekë, diferenca të cilat konfirmohen dhe nga analiza e kryer në Kolegji.

51. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se ka mospërputhje në kohën e blerjes, sipërfaqen dhe çmimin e blerjes, subjekti ka prapësuar se ka ardhur si pasojë e punimeve shtesë të cilat për shkak të vlerës së vogël nuk janë pasqyruar në aktet, si dhe për shkak të hartimit paraprakisht të kontratës premtimshite.

51.1. Lidhur me mospërputhjen në sipërfaqe, nga aktet rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti ka deklaruar se apartamenti është 87,452 m<sup>2</sup>, në deklaratën e vitit 2008 ka deklaruar sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, në kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 12.10.2009, ka deklaruar sipërfaqe ndërtimi 80,71 m<sup>2</sup> plus sipërfaqe e përbashkët 7,29 m<sup>2</sup>, ndërsa në kontratën e shitblerjes është deklaruar sipërfaqja 87,425 m<sup>2</sup>. Trupi gjykues vëren se për këto mospërputhje në deklarime duhet të merret në konsideratë koha kur janë bërë, reflektimi i sipërfaqeve të përbashkëta në pronësi të bashkëpronarëve, si dhe se nëse kanë qenë të finalizuara aktet për kolaudimin e apartamenteve të ndërtimit në tërësi, në të cilat jepen dhe sipërfaqet përfundimtare. Trupi gjykues konstaton se në dy kontratat, në atë të sipërmarrjes dhe në kontratën e shitblerjes, sipërfaqja e deklaruar është pothuajse e njëjtë, ndërsa deklarimi ndryshe i sipërfaqes së apartamentit në deklaratën *vetting* nga kontrata e shitjes, (nga 87,452 m<sup>2</sup> në 87,425 m<sup>2</sup>), mund të konsiderohet si një lapsus në shkrim nga subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, këto pasaktësi në deklaratimet e subjektit nuk duhen trajtuar me efekt në vlerësimin e saktësisë së deklaratimit të subjektit lidhur me vlerën e pasurisë objekt kontrolli.

51.2. Për sa i përket ndryshimeve në çmimin e blerjes, subjekti ka prapësuar se ka ardhur si pasojë e punimeve shtesë të kryera nga shoqëria ndërtimore, por nuk ka paraqitur asnjë dokument provues për këto punime shtesë dhe mbetet një pretendim i paprovuar i subjektit të rivlerësimit.

52. Ndërkohë, Kolegji vëren se nuk qëndron si shkak ankimi pretendimi i subjektit të rivlerësimit, që Komisioni ka konkluduar se është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e këtij apartamenti. Nga aktet rezulton se Komisioni ka konstatuar gjatë hetimit administrativ se çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë më i ulët, dhe se subjekti ka përfituar një çmim preferencial, gati sa gjysma e çmimeve referuar tregut të lirë të banesave. Subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës ka paraqitur në Komision kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*}, datë 10.11.2010, me palë shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe palë blerëse shtetasit G. D. dhe D. D., për apartamentin me sip. 70,075 m<sup>2</sup>, me çmimin 1.890.000 lekë. Komisioni, pasi shqyrtoi këtë kontratë, arriti në përfundimin se subjekti nuk ndodhet në kushtet e trajtimit preferencial nga shoqëria ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK sa i takon çmimit të blerjes së apartamentit, në Shëngjin, Lezhë.
53. Në përfundim, trupi gjykues çmon se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e llojit apartament me sip. 87 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

v) *Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 103,14 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë*

54. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në rrethanat dhe faktet për këtë pasuri si: përdorimi pa ndërprerje nga viti 2012 e në vazhdim; deklarimi për shpenzimet e mobilimit; lidhja e kontratës me UKT-në në emër të subjektit; investimi nga vëllai për blerjen e një pasurie tjetër para dy viteve; mungesa e të ardhurave të vëllait për të financuar blerjen e një apartamenti tjetër në Tiranë; si dhe mospërdorimi i këtij apartamenti nga vëllai, ka arritur në konkluzionin se kjo pasuri është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim ka vlerësuar se subjekti gjendet në situatën faktike të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
55. Subjekti i rivlerësimit ankimon se është krejtësisht i pambështetur vlerësimi i Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e 25% të apartamentit me sipërfaqe 103,14 m<sup>2</sup>, pasi gjatë hetimit administrativ subjekti ka depozituar faturat bankare të pagesës prej 15.000 eurosh, për shlyerjen e pjesës takuese të apartamentit, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, që mbulojnë tërësisht këtë vlerë të paguar. Gjithashtu, subjekti parashtron se ka paraqitur gjithë dokumentacionin lidhur me të ardhurat e vëllait në shtetin grek, që dokumentojnë mundësinë financiare të tij për pagesën e shumës 40.000 euro. Komisioni ka pasur mundësi që paqartësitë apo dyshimet në lidhje me dokumentacionin shoqëruar të të ardhurave të vëllait t'i verifikonte pranë autoriteteve greke dhe jo të dilte në përfundimin se është i paqartë dhe, për pasojë, të ardhurat nga emigracioni nuk konsiderohen burim i ligjshëm.
56. Lidhur me pretendimin e Komisionit se nga viti 2012 e në vijim faturat e apartamentit janë në emrin e subjektit, dhe se ky apartament ka qenë në përdorim të subjektit dhe jo të vëllait, subjekti parashtron se përdorimi i apartamentit prej tij ka qenë vetëm për periudhën e shkollës së fëmijëve, me miratimin dhe dijeninë e xhaxhait të tyre. Kontrata e ujit është lidhur në emër të subjektit, pasi i vëllai nuk ka pasur mundësi të vinte në Shqipëri për të lidhur kontratën.
57. Për sa i përket pretendimit të Komisionit se vëllai ka blerë një apartament në Shëngjin dhe nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar vlerën 40.000 euro për blerjen e apartamentit në Tiranë, nuk qëndron pasi të ardhurat e tij janë të dokumentuara me prova shkresore.
58. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 29.8.2012, pranë noteres Xh. P. O., së bashku me vëllain e tij, shtetasin A. N., me të cilën kanë porositur në shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK apartamentin me sip. 103,14 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 4,32 m<sup>2</sup>, me vlerë 60.000 euro, shumë e cila, sipas kontratës, është likuiduar plotësisht. Në këtë kontratë të dy vëllezërit figurojnë si porositës dhe nuk ka pjesë të përcaktuara për ndarjen e apartamentit.
59. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*, me përshkrimin: *Apartament me sip. 103,14 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 4,32 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. [...] porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2012, blerë në shumën 60.000 euro, së bashku me shtetasin A. N.. Për këtë pasuri subjekti ka deklaruar se ka paguar shumën 15.000 euro, me burim krijimi kursimet cash të deklaruara në vitet 2009, 2010, 2011 dhe një pjesë të vitit 2012. Pjesa tjetër në vlerën 45.000 euro është paguar nga bashkëpronari A. N., si kursime cash gjatë punës në shtetin grek, që prej vitit 1992. Pjesa takuese: 25%.*

60. Në DPV-në e vitit 2012, në ndryshimet e interesave private, subjekti ka deklaruar shtim pasurie të paluajtshme apartament banimi në bashkëpronësi me sip. 103,14 m<sup>2</sup>, tregu elektrik, Tiranë, në shumën 60.000 euro, me pjesë takuese 25% dhe prej tij është paguar shuma 15.000 euro, me burim kursimet familjare *cash* të deklaruara për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 (konvertuar në euro në muajin gusht 2012).
61. Banka Kombëtare Tregtare, me shkresat me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2021, dërguar Komisionit, ka konfirmuar pagesat: (i) *depozitim cash, datë 29.08.2012, shuma 15.000 euro, me përshkrim Jak P. Ndoka, Derdhje këst apartamenti në llogari të “{\*\*\*}” ShPK, (printuar nga sistemi i bankës me datë 06.01.2015 dhe mbajnë vulën e BKT-së, po me atë datë);* (ii) *depozitim cash, datë 28.08.2012, shuma 15.000 euro me përshkrim A. P. N., Derdhje në llogari të “{\*\*\*}” ShPK, (këst apartamenti, printuar nga sistemi i bankës me datë 06.01.2015 dhe mbajnë vulën e BKT-së, po me atë datë) – kjo pagesë është sjellë dhe bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. {\*\*\*} nga subjekti i rivlerësimit, si kopje e mandatit të bankës, datë 28.08.2012, firmosur nga A. N. me vulë të bankës në datën 28.08.2012;* (iii) *depozitim cash, datë 06.09.2012, shuma 25.000 euro, me përshkrim A. P. N., Derdhje këst apartamenti në favor të “{\*\*\*}” ShPK, (printuar nga sistemi i bankës me datë 06.01.2015 dhe mbajnë vulën e BKT-së, po me atë datë).* Nga këto akte rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer depozitim e pagesës prej 15.000 eurosh dhe vëllai A. N. ka kryer depozitim e pagesave prej 40.000 eurosh (në dy data të ndryshme), dhe në total të dy kanë paguar 55.000 euro.
62. Subjekti parashtron se ka paraqitur gjithë dokumentacionin, lidhur me të ardhurat e vëllait në shtetin grek, që dokumentojnë mundësinë financiare të tij për pagesën e shumës 40.000 euro, dhe se Komisioni ka pasur mundësi që paqartësitë apo dyshimet, në lidhje me dokumentacionin shoqëruar të të ardhurave të vëllait, ta verifikonte pranë autoriteteve greke dhe jo të dilte në përfundimin se është i paqartë dhe, për pasojë, të ardhurat nga emigracioni nuk konsiderohen burim i ligjshëm.

62.1. Për sa i përket këtij pretendimi, nga dokumentacioni në fashikujt e Komisionit, rezulton se sipas procesverbaleve të datave 13.10.2014, 19.12.2014 dhe 19.01.2015, të dërguara Komisionit nga ILDKPKI-ja<sup>11</sup>, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacionin për të ardhurat e vëllait në Greqi për periudhën 2002-2014, si dhe për një kredi të marrë nga vëllai në “Alpha Bank”, në vlerën 15.000 euro.

62.2. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dokumentacionin që vërteton të ardhurat e vëllait A. N. dhe bashkëshortes së tij, nga punësimi në Greqi, konkretisht këto akte:

- *Bashkëlidhur deklaratës vetting:* (a) certifikatë e gjendjes familjare, datë 27.10.2016, e A. N. me A. K. bashkëshorte dhe 1 fëmijë (lindur më 05.08.2001), me vërtetim nënshkrimi nr. {\*\*\*} rep., datë 28.01.2017, nga noter V. Gj. M.; (b) ekstrakt nga Regjistri Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, Greqi, datë 26.10.2016, për A. N., me të dhëna për periudhën 01.02.1998 - 31.08.2015, nr. {\*\*\*} rep., datë 28.01.2017, nga noter V. Gj. M.; (c) pasqyra e likuidimit tatimor të tatimit mbi të ardhurat e personit fizik në bazë të deklarimit fillestar për vitet 2003-2011, me vërtetim nënshkrimi nr. {\*\*\*} rep., datë 28.01.2017.

- *Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. {\*\*\*}:* (a) certifikatë e gjendjes familjare, datë 08.02.2021, e A. N. me A. K. bashkëshorte dhe 1 fëmijë (lindur më 05.08.2001), me vërtetim nënshkrimi nr. {\*\*\*} rep., datë 06.04.2021, nga notere M. I. D.; (b) ekstrakt nga akti i martesës,

<sup>11</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.01.2020.

datë 10.02.2021, e A. N. me A. K., bashkëshorte, në datën 08.09.2000, me vërtetim nënshkrimi nr. {\*\*\*} rep., datë 06.04.2021, nga notere M. I. D.; (c) informacion nga Instituti Sigurimeve Shoqërore, Greqi, datë 09.02.2021, për A. N., me të dhëna nga janari 2002 deri në dhjetor 2020; (ç) informacion të personalizuar për {\*\*\*}, detaje të biznesit, datë 10.02.2021, në të cilin jepet si datë fillimi biznesi data 12.07.2000; (d) raport i likuidimit të tatimit mbi të ardhurat e personit fizik, në bazë të deklaramit fillestar për vitin 2003-2012 (pa vitin 2010).

63. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se ky apartament ka qenë në përdorim të tij dhe jo të vëllait, pasi nga viti 2012 e në vijim faturat e apartamentit janë në emrin e tij, duke parashtruar se përdorimi i apartamentit prej tij ka qenë vetëm për periudhën e shkollës së fëmijëve, me miratimin dhe dijeninë e xhaxhait të tyre. Kontrata e ujit është lidhur në emër të subjektit, pasi i vëllai nuk ka pasur mundësi të vinte në Shqipëri për të lidhur kontratën.

63.1. Referuar të dhënave nga UKT-ja, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka hapur në datën 29.10.2012, në emër të tij, kontratën me nr. {\*\*\*}, për objektin në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

64. Subjekti kundërshton dhe konstatimin e Komisionit se vëllai ka blerë një apartament në Shëngjin dhe nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar vlerën 40.000 euro, për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi sipas tij, të ardhurat e vëllait janë të dokumentuara me prova shkresore. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti në kuadër të barrës së provës ka paraqitur në Komision dokumentin “Vërtetim nga dokumenti hipotekor”, sipas së cilit vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2017, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve M. P. N. dhe D. L. N., pasuria me numër {\*\*\*}, sip. 66,6 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Zonën Kadastrale {\*\*\*}, në adresën Shëngjin, Lezhë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dhe dy mandatpagesa në “Credins Bank”, të datave 02.10.2017 dhe 03.10.2017, për pagesa të kryera nga vëllai M. N., në vlerat 8.600 dhe 11.400 euro.

64.1. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se gjatë hetimit të zhvilluar në Komision ka rezultuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit, A. N., ka lidhur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 02.03.2010, për blerjen e apartamentit me sip. 75 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, kundrejt çmimit 22.000 euro, në të cilën shtetasi F. B. deklaroi se në datën 19.5.2009 ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje për ndërtim apartamenti me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për disa apartamente në pallatet që është duke ndërtuar në Shëngjin, Lezhë dhe ka rënë dakord që një nga këto apartamente t’ia shesë shtetasit A. N., me çmimin 22.000 euro. Në këtë deklaratë palët kanë deklaruar se është likuiduar shuma prej 10.000 eurosh nga A. N. dhe kësti i fundit prej 12.000 eurosh do të paguhej me nënshkrimin e kontratës përfundimtare dhe regjistrimin e pronës në ZVRPP-në Lezhë.

64.2. Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë argument apo provë për të kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se vëllai ka blerë një pasuri tjetër, por është mjaftuar me argumentin që të ardhurat e vëllait janë të dokumentuara me prova shkresore. Dokumentacioni që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, për një pronë në Shëngjin në pronësi të vëllait tjetër M. N., duke mos pasur asnjë referencë në numër pasurie apo lidhje me apartamentin e porositur nga vëllai tjetër, A. N., nuk sjell asnjë të dhënë relevante që do të mbështeste pretendimin e subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, duke qenë se subjekti nuk arrin të provojë që vëllai nuk ka kryer një investim tjetër dy vjet para blerjes së apartamentit në Tiranë, Kolegji

çmon se pretendimet e subjektit në këtë drejtim mbeten në kuadrin deklarativ dhe të pambështetura në prova.

65. Për sa rezulton nga aktet sa më sipër, si dhe nga konkluzionet e Komisionit dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se të vetmet akte mbi të cilat subjekti bazon pretendimet e tij, mbi bashkëpronësinë e apartamentit në Tiranë, janë kontrata e sipërmarrjes, si dhe pagesat e kryera në bankë, mbi bazën e të cilave ai pretendon se ka 25% të apartamentit. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti as të argumentojë se përse nuk është arritur të finalizohet minimalisht një kontratë përfundimtare shitjeje për këtë pasuri, duke konsideruar kohën e gjatë të përdorimit të këtij apartamenti nga familjarët e tij.
66. Kolegji vëren se ekzistenca e kontratës me UKT-në, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për shpenzime mobilimi dhe për përdorimin ekskluziv të apartamentit nga fëmijët e tij gjatë periudhës së shkollës, janë indicie të cilat çojnë në dyshime të arsyeshme për një pasuri në pronësi vetëm të subjektit të rivlerësimit.
67. Për sa u përket pretendimeve për mundësinë financiare të vëllait për blerjen e pjesës takuese të apartamentit, Kolegji vlerëson se edhe në rast se subjekti do të arrinte të provonte me dokumentacion të plotë justifikues të ardhurat e të vëllait, gjithsesi ai nuk arrin të bindë se këto të ardhura janë përdorur nga i vëllai për blerjen e apartamentit. Vetëm fakti i kryerjes së dy pagesave nga vëllai i subjektit, ndërkohë që nuk provohet asnjë lidhje tjetër e tij me apartamentin në fjalë, nuk provon bashkëpronësinë e tij në këtë apartament.
68. Kolegji vëren se Komisioni, sipas përfundimeve të arritura në vendim, pas kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit dhe pas kryerjes së analizës financiare të vitit 2012, ka konstatuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë rezultuar se nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të mbuluar me burime të ligjshme pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 103,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën prej 60.000 eurosh, kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2012, i cili ka rezultuar me diferencë negative prej (-) 6.236.317 lekësh, diferencë e cila konstatohet dhe në analizën e Kolegjit.
69. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 103,14 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me fshehjen e këtij apartamenti dhe gjendet në situatën faktike të pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.  
*vi) Lidhur me pasurinë automjet “Daimler Chrysler”, blerë me kontratën e datës 21.06.2014*
70. Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se në vitin 2013 subjekti, paraprakisht, rezulton me një balancë negative të fondeve, pra, me një pamundësi në dukje për të krijuar shumën prej 500.000 lekësh të deklaruar si shtesë kursimesh në vitin 2013, mundësia për kursim në këtë vit ka qenë në vlerën 102.278 lekë (500.000 lekë - 397.728 lekë). Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ, për automjetin tip “Daimler Chrysler”, në drejtim të vërtetimit të mundësive financiare për blerjen e automjetit.
71. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar në përdorim automjetin tip “Mercedes Benz 220”, në emër të vëllait, në deklaratat e interesave private periodike/vjetore të viteve 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013.



72. Për sa i përket pretendimit të Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit, subjekti parashtron se ky konstatim është i pabazuar, pasi prej tij është provuar me dokumente shkresore ekzistenca e të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme. Komisioni ka përlllogaritur si shpenzime udhëtimet në Greqi dhe në Itali të të afërmit e subjektit, pa marrë në konsideratë dokumentet e paraqitura nga subjekti që vërtetojnë se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga palët e treta.
73. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratat vjetore 2008-2013 të përdorimit të automjetit në pronësi të vëllait, subjekti parashtron se nuk ka pasur nevojë për përdorimin e një mjeti përditë dhe në raste emergjence ka përdorur automjetin e vëllait.
74. Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, Kolegji, referuar në dokumentacionin e fashikullit, konstaton se:
- 74.1. Në deklaratën *vetting*, si dhe deklaratën e vitit 2014, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler” kursimet *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2013. Në DPV-në 2013, subjekti ka deklaruar *shtuar si kursime familjare në vlerën 500.000 lekë*.
- 74.2. Në kontratën e shitblerjes së automjetit të datës 21.06.2014 është deklaruar se çmimi prej 500.000 lekësh është likuiduar dhe automjeti është marrë në përdorim pa pretendime për gjendjen teknike.
- 74.3. Komisioni, për të evidentuar mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për të kursyer shumën prej 500.000 lekësh në vitin 2013, ka kryer analizën financiare për këtë vit, pas së cilës ka konstatuar se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e deklaruar *cash* në shumën 500.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara. Pamjaftueshmërinë e të ardhurave për blerjen e automjetit Komisioni e ka lidhur me pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme kursimet shtesë në vitin 2013 prej 500.000 lekësh – të deklaruara si burim i përdorur për automjetin – dhe nga analiza financiare viti 2013 ka rezultuar me diferencë negative në vlerën (-) 397.728 lekë ose mundësia për të kursyer deri në vlerën prej 102.278 lekësh (500.000 lekë deklaruar kursime – 397.728 lekë rezultati i analizës financiare të vitit).
- 74.4. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, lidhur me shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013, ka kundërshtuar analizën e Komisionit, duke u shprehur se: *Analiza e shpenzimeve e realizuar nga Komisioni në rubrikën për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën është llogaritur në mënyrë të gabuar, pasi në pyetësorin e parë e kam sqaruar se kam qenë për një vizitë me rastin e martesës së vajzës së T. S., në Fano, Itali dhe më pas në Hania, Greqi, ku kam sqaruar se shpenzimet gjatë qëndrimit janë përballuar nga vëllezërit e mi A. N. dhe V. N.. Për këtë fakt, shpenzimet për udhëtim në vitin 2013 dhe qëndrimi jashtë vendit për këtë periudhë nuk janë llogaritur mbi bazën e deklaramit tim në pyetësorin e parë se në udhëtimin në Greqi shpenzimet gjatë qëndrimit janë përballuar nga vëllezërit e mi [...].*
- 74.5. Në mbështetje të pretendimeve të tij për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dy deklarata nga shtetasit T. S. dhe B. Gj., të cilët kanë deklaruar se gjatë udhëtimit në Itali, (pa specifikuar data apo periudha), të subjektit dhe familjes së tij, shpenzimet e qëndrimit, (akomodim, ushqim, lëvizje), janë mbuluar prej tyre.
- 74.6. Komisioni ka konkluduar se këto deklarata, bazuar në nenin 261 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak se nuk janë hartuar para një noteri, sa i takon formës, nuk kanë fuqi provuese. Gjithashtu,

në përmbajtje deklaratat nuk përcaktojnë kohën e qëndrimit dhe, për këtë arsye, sipas Komisionit nuk përbëjnë fuqi provuese as sipas përmbajtjes.

75. Për sa ka konkluduar Komisioni dhe pretendon subjekti i rivlerësimit, sillet në vëmendje qëndrimi i Kolegjit<sup>12</sup> në raste të mëparshme se deklaratat e paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit kanë vlerë të kufizuar provuese në këtë proces, nëse nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit. Vlera provuese e këtyre deklaratave vlerësohet nga trupi gjykues rast pas rasti, në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklaratimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj.
76. Në rastin konkret, për udhëtimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij për vitin 2013, në Itali, Kolegji çmon se ai nuk arrin të provojë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit pasi i vetmi dokument që ka paraqitur është një deklaratë me shkrim dore nga shtetasi T. S., pa datë dhe pa të dhëna për periudhat e udhëtimeve, si dhe një kopje kontrate shitblerjeje të një apartamenti në Itali, me blerës këtë shtetas. Prandaj, Kolegji çmon si të drejtë vlerësimin e Komisionit që në analizën financiare i ka konsideruar këto shpenzime udhëtimi për llogari të subjektit të rivlerësimit.
77. Për sa i përket udhëtimit në Greqi për periudhën 12-23.08.2013, për të cilin subjekti ka deklaruar se shpenzimet e qëndrimit janë përballuar nga vëllezërit e tij, duke marrë në konsideratë lidhjen e ngushtë familjare, si dhe destinacionin e udhëtimit, që është në të njëjtin vend ku vëllai ka vendqëndrimin, në Kretë, Kolegji vlerëson se për këtë udhëtim shpenzimet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit duhet të reduktohen. Në analizën financiare të Kolegjit u krye reduktimi i këtij shpenzimi për udhëtimin e familjes së subjektit të rivlerësimit në Greqi të vëllezërit, dhe mbështetur në metodologjinë e aplikuar në Kolegj<sup>13</sup>, duke rrillogaritur shpenzimet e udhëtimit në vitin 2013, në vlerën prej 228.627 lekësh, pra, duke u ulur nga vlera 498.411 lekë e llogaritur nga Komisioni<sup>14</sup>, analiza e vitit 2013 rezultoi me diferencë më të ulët, në vlerën prej (-) 127.944 lekësh.
78. Në përfundim, lidhur me automjetin “Daimler Chrysler”, të blerë në vlerën prej 500.000 lekësh, me burim kursimet e vitit 2013, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj për vitin 2013, duke reflektuar në përlllogaritje reduktimin e shpenzimeve për udhëtimin e kryer nga familja në Greqi të vëllezërit, analiza e vitit 2013 rezultoi me një diferencë prej (-) 127.944 lekësh. Pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerëson se ai nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e deklaruar në likuiditete *cash* në shumën 500.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2013, pasi mundësitë për kursim në këtë vit kanë qenë deri në vlerën 372.056 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative prej 127.944 lekësh, për blerjen e këtij automjeti.
79. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar në përdorim automjetin tip “Mercedes Benz 220”, në emër të vëllait, në deklaratat e

---

<sup>12</sup> *Shih Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.*

<sup>13</sup> *Referuar në Vendimin e Kolegjit nr. 11 datë 22.05.2019, për subjektin e rivlerësimit E. Islamaj, me kosto qëndrimi të të afërmit prej 5 euro/dita/ secili.*

<sup>14</sup> *Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni në raportin e rezultateve hetimore për vitin 2013, kanë përlllogaritur shpenzime udhëtimi prej 498.411 lekësh (ose 3.555 euro), e sipas shpjegueses është konsideruar metodologjia e aplikuar në Kolegj (referuar çështjen nr. 11, datë 22.05.2019, të E. Islamaj).*

interesave private periodike/vjetore të viteve 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, subjekti në ankim ka parashtruar se: [...] *banoj në qytetin e Lezhës, 500 m larg vendit të punës dhe nuk më është dashur të përdor një mjet në mënyrë të përditshme dhe të domosdoshme dhe ndonjë rast kur më është dashur për ndonjë emergjencë kam përdorur automjetin e vëllait [...].*

80. Nga aktet në fashikull konstatohet se subjekti për herë të parë përdorimin e këtij automjeti e ka deklaruar në ILDKPKI, në datën 13.10.2014, ku ka deklaruar se: [...] *nga viti 2008 deri në vitin 2013 kam përdorur makinën e vëllait. Në vitin 2014 kam blerë makinën personale.*
81. Në pyetësonin standard, pyetjes nëse ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër, subjekti i është përgjigjur se: [...] *gjatë periudhës së deklarimit kam përdorur autoveturën në pronësi të vëllait M. N. të markës “Mercedes Benz”, ngjyrë e zezë. Gjithashtu, gjatë periudhës 2018 -2019 kam përdorur autoveturën e vajzës J. N. të markës “Mercedes B-Class”, me ngjyrë të zezë e targë {\*\*\*}.*
82. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se *në lidhje me përdorimin e makinës së vëllait M. P. N. nga viti 2008 - 2013, ju sqaroj se mund të jetë harruar.*
83. Nga verifikimi i lëvizjeve sipas sistemit *TIMS*,<sup>15</sup> që i përkasin periudhës 2008-2013, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë lëvizur jashtë shtetit me makinën në pronësi të vëllait.
84. Kolegji vëren se nuk rezulton të ketë dokumente që të dëshmojnë përdorimin e vazhdueshëm të këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit (akt-përdorimi apo polica sigurimi në emër të subjektit). Komisioni e ka konstatuar përdorimin e automjetit nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas deklarimeve që ai ka bërë në pyetësonin standard. Nga vetë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit del se ai e ka përdorur këtë automjet jo në mënyrë të vazhdueshme, dhe se në lëvizjet jashtë shtetit ai ka udhëtuar si pasagjer me këtë automjet.
85. Gjithashtu, provohet nga aktet e fashikullit se subjekti i rivlerësimit nuk e ka pasur në përdorim automjetin në fjalë në periudhën e paraqitjes së deklaratës së pasurisë *vetting*. Ky fakt, si dhe mungesa e provave për përdorimin e vazhdueshëm të automjetit gjatë periudhës 2008-2013, krijojnë bindjen e Kolegjit se subjekti i rivlerësimit, në momentin e deklarimit *vetting*, nuk ka qenë në shkelje të detyrimit të deklarimit, sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasurinë në përdorim.

*vii) Lidhur me pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të fituara, sipas ligjit nr. 7501*

86. Subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar: *Pasuri në bashkëpronësi përfitur si anëtar i familjes bujqësore dhe trashëgimisë: (i) pasuria e llojit pemëtore me sipërfaqe 875 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Lezhë; (ii) pasuria e llojit tokë arë 3,925 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Lezhë; (iii) pasuria e llojit pemëtore-truall 1,200 m<sup>2</sup>, nga kjo 300 m<sup>2</sup> truall, nga kjo 66 m<sup>2</sup> ndërtesë në {\*\*\*}, Lezhë; (iv) pasuria e llojit arë me sip. 5,315 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Lezhë, dhe se këto pasuri janë në bashkëpronësi si anëtar i familjes bujqësore, përfitur nga ligji nr. 7501 “Për tokën”.*
87. Komisioni ka konkluduar se në analizë të fakteve dhe rrethanave në lidhje me mosdeklarimin në DPV-të e viteve 2003-2011, të këtyre pasurive, subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë. Komisioni ka vlerësuar se kjo pasaktësi, nëse do të ishte e vetme, nuk do të sillte automatikisht shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

<sup>15</sup> *Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 27.09.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*

88. Subjekti pretendon në ankim se burimi i krijimit të tyre është i njohur dhe i ligjshëm dhe fakti që nuk janë deklaruar në vitin 2004, në deklarimin fillestar të pasurisë, ka ardhur si pasojë e pakujdesisë, dhe se nuk ka pasur si qëllim për t'i fshehur këto pasuri. Fakti që gabimi është riparuar, pasi këto pasuri janë deklaruar më vonë dhe në deklaratën *vetting*, sipas subjektit, nuk përbën shkelje të tillë që të bëhet shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
89. Lidhur me sa pretendon subjekti, Kolegji fillimisht konstaton se Komisioni nuk është shprehur në vendim në drejtim të ligjshmërisë së burimeve apo të fshehjes së pasurive nga subjekti i rivlerësimit, por për pasaktësitë në deklarim, për shkak të mosdeklarimit të këtyre pasurive në deklaratën fillestare të vitit 2003. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parë në vitin 2003 nuk i ka deklaruar këto pasuri të paluajtshme, të drejtat reale mbi to, përfshirë edhe burimin e tyre të krijimit. Këto pasuri nuk janë deklaruar edhe në DPV-të vijuese deri në DPV-në e vitit 2011.
90. Kolegji çmon se vlerësimi për deklarimin e këtyre pasurive duhet të bëhet në varësi të statusit të subjektit të rivlerësimit si përfitues si anëtar i familjes bujqësore dhe si trashëgimtar ligjor i pjesës takuese të të atit, pas vdekjes së tij.
91. Si anëtar i familjes bujqësore, sipas ligjit nr. 7501 “Për tokën” dhe Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi të vitit 1995, subjekti ka pasur detyrimin që pjesën takuese ta deklaronte që në deklaratën fillestare të vitit 2003, pasi këto pasuri janë fituar nga familja e tij para këtij viti<sup>16</sup>.
92. Për sa i përket pjesës takuese si trashëgimtar ligjor pas vdekjes së të atit, nga aktet në fashikull, rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pas kërkesës së vëllait të subjektit të rivlerësimit M. N., është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për trashëgimtarët e P. N., babai i subjektit të rivlerësimit, i cili ka vdekur në vitin 2005. Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 05.09.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë i përcjell ZVRPP-së Lezhë vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.
93. Në dokumentacionin e përcjellë në Komision nga ZVRPP-ja Lezhë figuron nga kartelat e pasurive të mësipërme se lëshimi i certifikatave të pronësisë, sipas dëshmisë së trashëgimisë, është bërë në datën 13.09.2011. Pas regjistrimit në ZVRPP-në Lezhë, subjekti ka pasqyruar shtesat në pasuri të paluajtshme në deklaratën periodike të vitit 2011, të cilat i ka deklaruar dhe në deklaratën *Vetting*. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar se pasurinë e ka përfitur me ligjin nr. 7501, por pa e specifikuar që një pjesë e saj është fituar dhe nga trashëgimia ligjore. Gjithashtu, edhe pjesët takuese janë deklaruar në mënyrë të pasaktë (ka deklaruar pjesën takuese 1/6, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* pjesa takuese është 7/36).
94. Në përfundim, Kolegji, duke konstatuar vonesat në regjistrimin e këtyre pasurive, si dhe mënyrën e deklarimit të subjektit, vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë dhe të paplotë për pasuritë tokë në bashkëpronësi me anëtarët e familjes bujqësore, por që këto pasaktësi, të vetme, nuk do të sillnin automatikisht shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
95. Në vlerësimin tërësor të çështjes, referuar shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me analizën financiare të viteve, Kolegji, edhe pas pranimit të disa prej pretendimeve për

<sup>16</sup> Sipas akteve që ka paraqitur vetë subjekti bashkë me deklaratën *vetting*: Kartelat e pasurisë për arën me sip. 3,925 m<sup>2</sup>, pemëtoren 1,200 m<sup>2</sup>, arën me sip. 5,795 m<sup>2</sup>, arën me sip. 3,925 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të P. N. në vitin 1998; Akt të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {\*\*\*}, datë 25.5.1995, në emër të P. N..

llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, trajtuar sa më sipër në analizën e vitit 2013<sup>17</sup>, e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të rezulton me balancë negative për periudhën 2006-2016.

96. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Jak Ndoka gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 3 dhe pikën 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 477, datë 24.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 477, datë 24.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Jak Ndoka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.11.2022, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

---

<sup>17</sup> Për të cilën me uljen e përlogaritjes së një shpenzimi udhëtimi në Greqi te vëllai, u korrigjua diferenca negative nga (-) 397.728 lekë konkluduar nga Komisioni në (-) 127.944 lekë.

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores, jam dakord me vendimin nr. 45, datë 17.11.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Jak Ndoka, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 477, datë 24.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur, lidhur me një nga pasuritë e subjektit të rivlerësimit, konkretisht me pasurinë apartament me sipërfaqe 103,14 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë.
2. Trupi gjykues i Kolegjit, për pasurinë apartament me sipërfaqe 103,14 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, në paragrafin 69 të vendimit ka konkluduar se: *Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 103,14 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, lidhur me fshehjen e këtij apartamenti dhe gjendet në situatën faktike të pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
3. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, që mbështeti konkluzionin e Komisionit, nuk arrita të krijoj bindjen se pasuria e mësipërme është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe të kualifikohej në kushtet e nenit D, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, duke argumentuar sa më poshtë.
4. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në DPV-në e vitit 2012:
  - Porosinë e apartamentit me sip. 103,14 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 4,32 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2012, vlerën e apartamentit prej 60.000 eurosh, si dhe bashkëpronësinë për të, në pjesë takuese prej 25%, me vëllain A. N..
  - Subjekti ka deklaruar se ka paguar vlerën prej 15.000 eurosh, që i korrespondon edhe pjesës takuese të tij. Si burim krijimi për pjesën e tij, subjekti ka deklaruar kursimet *cash* në vitet 2009, 2010, 2011 dhe një pjesë të vitit 2012. Kjo provohet me depozitimin në *cash* të shumës prej 15.000 eurosh në datën 29.08.2012, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me përshkrimin *Jak P. Ndoka, derdhje këst apartamenti në llogari të “{\*\*\*}” ShPK.*
  - Lidhur me pjesën tjetër të pagesës së apartamentit, në vlerën 45.000 euro, është paguar nga bashkëpronari tjetër, vëllai i subjektit. Pagesa prej 40.000 eurosh provohet me dy depozitimet *cash* të kryera nga A. N., respektivisht në datat 28.08.2012 dhe 06.09.2012, të shumave 15.000 euro dhe 25.000 euro, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me përshkrimin *A. P. N., derdhje këst apartamenti në favor të “{\*\*\*}” ShPK.*
5. Shumica e trupit gjykues të Kolegjit duhet të mbante në konsideratë faktin që pjesa në përqindje e sipërfaqes takuese të apartamentit në bashkëpronësi përcaktohet në kontratën përfundimtare të shitjes, kalimit të pronësisë e më pas regjistrimit të saj, kontratë e cila nuk rezulton të jetë hartuar ende nga palët deri në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*.
6. Lidhur me përdorimin pa ndërprerje të apartamentit nga viti 2012 e në vazhdim, si dhe deklarimin për shpenzimet e mobilimit nga ana e subjektit, vlerësoj se qëndron pretendimi se në kushtet kur vëllezërit kishin rënë dakord që fëmijët e subjektit të qëndronin në këtë banesë të përbashkët gjatë periudhës së studimit në Tiranë dhe vëllai i subjektit është me banim të përhershëm në Greqi, është e arsyeshme dhe e pranueshme që përdorimi të deklarohet prej subjektit, si dhe mobilimi të bëhet prej tij. Shumica nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se

përdorimi i apartamentit, vërtet ka qenë pa ndërprerje, por vetëm për vitet e shkollimit të fëmijëve të subjektit.

7. Lidhur me konsiderimin nga Komisioni e Kolegji të faktit se kontrata me UKT-në është lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit dhe përbën një provë në favor të konkluzionit për një pasuri të fshehur, ndaj mendim të kundërt, për sa kohë nuk ka asnjë parashikim ligjor që përcakton se kontratat për ujë e drita duhet të lidhen njëkohësisht nga të gjithë bashkëpronarët. Konstatohet se kontrata me nr. {\*\*\*} me UKT-në është lidhur në datën 29.10.2012, periudhë që korrespondon me fillimin e vitit akademik dhe që provon deklarinimin e subjektit se apartamenti është përdorur nga fëmijët e tij gjatë studimeve dhe, gjithashtu, provon edhe pamundësinë e vëllait të subjektit për të ardhur nga Greqia vetëm për lidhjen e kontratave ujë e drita, duke pasur parasysh që ai ishte në Shqipëri në periudhën gusht-shtator të vitit 2012.
8. Komisioni, sipas përfundimeve të arritura në vendim, ka përfshirë pamjaftueshmërinë e mbulimit me burime të ligjshme<sup>18</sup> të vitit 2012 të të gjithë vlerës së çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 103,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, prej (-) 6.236.317 lekësh në ngarkim të subjektit të rivlerësimit dhe jo vetëm pjesën e deklaruar prej tij në deklaratën *vetting* dhe DPV-në e vitit 2012, për pjesën e paguar prej 15.000 eurosh, pasi ka konkluduar se pasuria është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, përfundim i mbështetur edhe nga shumica e trupit gjykues.
9. Në ndryshim me këtë qëndrim, vlerësoj se do të duhej të ishin analizuar burimet deri në datën e krijimit të pasurisë në datën 29.08.2012, kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, mbështetur dhe në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit për burimet si përdorim të kursimeve *cash* të deklaruara në vitet 2009-2011 dhe një pjesë të vitit 2012. Nëse do të konsiderohej në analizë vetëm pjesa e pretenduar, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit prej 15.000 euro, (ose 2.095.800 lekë), si e paguar prej tij për blerjen e apartamentit në Tiranë, atëherë do të rezultonte se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi me kursimet e mundshme deri në momentin e blerjes së pasurisë më 29.08.2012, të mbulonin me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë (për pjesën e tij), kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve bankare.
10. Lidhur me të ardhurat e vëllait të subjektit A. N. e të bashkëshortes së tij, Komisioni ka vlerësuar se: *Referuar hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, lidhur me mundësinë financiare të vëllait të subjektit për kryerjen e këtij investimi në vlerën 45.000 euro, për apartamentin e përbashkët me subjektin në vitin 2012, rezulton se vëllai i subjektit në vitin 2010 ka kryer blerje të një tjetër pasurie të paluajtshme, në Shëngjin, Lezhë, duke paguar vlerën 22.000 euro me këste për periudhën 2010-2011, për më tepër që dokumentacioni i dërguar në lidhje me të ardhurat e vëllait në shtetin grek është i paqartë, si dhe aktet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë financiare të vëllait të subjektit për blerjen, (bashkë me subjektin e rivlerësimit), e apartamentit me sip. 103 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vitin 2012<sup>19</sup>.*
11. Ndaj vlerësim të njëjtë me trupin gjykues për pamundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pjesës takuese të apartamentit. Bazuar në një analizë të thjeshtë të kryer mbi bazë të të ardhurave të ligjshme të dokumentuara, rezulton se vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij në shtetin grek mund të krijonin kursime, por jo në masën për të mbuluar tërësisht investimin e kryer në vlerën prej 40.000 eurosh. Pra, nuk provohet mundësia financiare e vëllait të subjektit për mbulimin

<sup>18</sup> Paragrafi 4.19 i vendimit të Komisionit.

<sup>19</sup> Paragrafi 4.15 i vendimit të Komisionit.

total të investimit për blerjen e pjesës takuese të apartamentit me sip. 103 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vitin 2012, me të ardhurat e ligjshme të dokumentuara.

12. Sa i përket konstatimit që pamundësisë financiare të vëllait të subjektit i shtohet edhe investimi në blerjen e një apartamenti në Shëngjin, Lezhë, nga aktet në fashikull, konstatohet se nga përgjigjja zyrtare që ZVRPP-ja Lezhë i ka dërguar Komisionit nuk rezulton që vëllai A. N. të ketë pasuri të regjistruar në Shëngjin. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë argument apo provë për të kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se vëllai ka blerë një pasuri tjetër, vlerësoj se ky fakt i parashtruar nga Komisioni dhe shumica e trupit gjykues mbetet deklarativ dhe nuk duhet të shërbejë si një argument shtesë për të rënduar pamundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit.
13. Për sa analizuar më lart, arrij në konkluzionin se pasuria apartament me sip. 103,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, është një pasuri e deklaruar saktësisht dhe plotësisht nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, si pasuri në bashkëpronësi me të vëllanë A. N. dhe nuk mund të jetë një pasuri e fshehur.
14. Për këtë pasuri rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të paguajë me të ardhura të ligjshme pjesën takuese të tij prej 25% në vlerën 15.000 euro, ndërsa vëllai A. N. me të ardhurat e ligjshme të dokumentuara rezulton se mund të krijonte kursime, por jo në masën për të mbuluar investimin e kryer në vlerën prej 40.000 eurosh, pra, është në pamundësi për mbulimin total të investimit me të ardhurat e ligjshme të dokumentuara.
15. Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament me sip. 103,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, çmoj se subjekti i rivlerësimit Jak Ndoka, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*